

PËRMBLEDHJE JO – TEKNIKE

EMËRTIMI I PROJEKTIT:

SHFRYTËZIM I INERTEVE LUMORE, NË AFERSI TE FSHATIT LAPANJ

VENDNDODHJA

NE AFERSI TE FSHATIT LAPANJ, BASHKIA COROVODE,

QARKU BERAT

Kërkues:

Subjekti “SALILLARI” Sh.p.k

NIPT: J62903125G

Përmbledhje

1. Hyrje	3
2. Vendndodhja e projektit	3
3. Përshkrim i projektit	6
4. Karakteristikat e projektit karrierë për shfrytëzimin e gurit gëlqeror	6
5.1 Kryerja e punimeve për shfrytëzimin e karrierës.....	Error! Bookmark not defined.
5.2 Parashikimi i realizimit të prodhimit në objekt.....	Error! Bookmark not defined.
5.3 Rradha dhe drejtimi i shfrytëzimit	Error! Bookmark not defined.
5.4 Punët me lëndët plasëse.....	Error! Bookmark not defined.
5.5 Organizimi	9
Masat për rregullimin e infrastrukturës	9
Hapja e kanaleve për drenazhim midis kollonës mbrojtëse dhe zonës së shfrytëzimit	9
Punimet plotësuese për mbylljen e karrierës	9
5. Informacion mbi përzgjedhjen e vendndodhjes së projektit	10
6. Identifikimi i ndikimeve	11
1. Ndikimet në tokë.....	Error! Bookmark not defined.
2. Ndikime në topografinë lokale, erozionin e tokës	Error! Bookmark not defined.
3. Ndikimet në ujë.....	Error! Bookmark not defined.
4. Ndikimet në ajër.....	Error! Bookmark not defined.
5. Ndikime në zhurma dhe vibrime.....	Error! Bookmark not defined.
6. Ndikimet në biodiversitet	Error! Bookmark not defined.
7. Ndikime në infrastrukturën e zonës	Error! Bookmark not defined.
8. Ndikime në trashëgiminë kulturore.....	Error! Bookmark not defined.
9. Ndikime të tjera	Error! Bookmark not defined.
7. Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit	15

1. Hyrje

Shoqëria “Salillari” sh.p.k. ka selinë e vet kryesore në rrugën e vjetër Vorë – Marikaj, km 1, godina katër katëshe, kati i tretë, Nr 5 (sipas Ekstraktit të QKR). Kjo shoqëri është e regjistruar në regjistrin tregtar me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit (NIPT): J62903125G me datë regjistrimi 10.08.1994.

Bazuar në kontratën e lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar për zbatimin e projektit “Ndërtimi i aksit rrugor Skrapar – Përmet, Loti 1”, kjo shoqëri do të zhvillojë aktivitetin e saj “Shfrytëzim inertesh lumore”, me vendndodhje në fshatin Lapanj, Bashkia Corovodë, rrethi Skrapar.

Qëllimi i përgatitjes së Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është pikërisht identifikimi i impakteve negative dhe pozitive që do të ketë ky aktivitet në mjedisin rrethues si dhe impaktin social – ekonomik.

2. Vendndodhja e projektit

Objekti “Karrierë për shfrytëzim inertesh lumore” bën pjesë në zonën administrative të rethit të Skraparit, qarku Berat. Ai ndodhet në të majte të rruges që lidh Skraparin me Permetin dhe kryesisht fshatrat Lapanj – Malind. Vendndodhja e objektit përputhet plotësisht me synimin e shoqërisë për zbatimin e projektit sipas kontratës së lidhur.

Objekti në aspektin gjeografik, zona ku do të bëhet shfrytëzimi bën pjesë në planshetin topografik të shkallës 1: 25000 me nomenklaturë K-34-125-D-a (Cepani). Kufiri i zonës jepet sipas koordinatave të mëposhtme:

Koordinatat e zonës 1 me sipërfaqe 0.28 km^2 që kërkohej për leje mjedisi

	x	y
1	4476964	4440409
2	4476952	4440342
3	4476414	4440595
4	4476527	4441144
5	4476512	4441448
6	4476641	4441713
7	4476784	4441893
8	4476853	4441597
9	4476704	4441244
10	4476563	4440944
11	4476563	4440807

Kordinatat e zones 2 me sip = 0.17 km² qe kerkohet per leje mjedisi

	x	y
1	4477005	4442200
2	4476846	4442283
3	4476987	4442480
4	4477189	4442983
5	4477128	4443254
6	4477270	4443440
7	4477312	4443695
8	4477427	4443679
9	4477281	4443291
10	4477308	4443004

Kordinatat e zones 3 me sip = 0.31 km² qe kerkohet per leje mjedisi

	x	y
1	4477517	4443868
2	4477267	4444137
3	4477341	4444684
4	4477552	4444885
5	4477754	4445225
6	4478424	4445559
7	4478636	4445515
8	4478095	4445272
9	4477647	4444801
10	4477359	4444124

Nga studimi gjeologjik qe eshte bere, ka rezultuar se per nevojat e projektit eshte e mjaftueshme vetem shfrytezimi i zones se pare me sip = 0.28 km².

Rruga aktuale që do të përdoret më shumë është rruga që lidh karrierën e rrugës Ura Vajguore – Konizbaltë.

Në objektin karrierë për shfrytëzim inerte lumore, në lumen Osum, rezervat e shfrytëzueshme janë 134,019 m³ masiv.



Foto ajrore e zones

Objekti, sic është lartpërmendur, ndodhet në një distancë në vijë ajrore rreth 1 km nga fshati Lapanj. Gjithashtu ndodhet në një distancë prej rreth 2.2 km, në vijë ajrore, nga fshati Malind.



3. Përshkrim i projektit

Projekti lidhet me ndertimin e aksit rrugor Skrapar – Përmet, Loti 1. Për zbatimin e këtij projekti do të shfrytëzohen pikërisht inertet lumore të lumit Osum.

Shoqëria “Salillari” sh.p.k ka marrë në zotërim edhe lejen për “Shfrytëzim të inerteve lumore”, dhënë nga Këshilli I Basenit të Semanit.

Teknologjia që do të përdoret për shfrytëzimin e inerteve lumore do të jetë e thjeshtë, duke instaluar makineritë e hapjes së birave, makinat vetngarkuese dhe ato të transportit të inerteve për në kantierin e ndërtimit, ku do të vendoset Nyja e fraksionimit.

Kantieri normalisht do të punojë me një turn dhe në varësi të kërkesës dhe afateve të zbatimit të projektit, karriera do të punojë me orare të zgjata, pa e ndërprerë prodhimin deri në plotësimin e kërkesës.

4. Karakteristikat e karrierës

4.1 NDERTIMI GJEOLOGJIK I ZONES

Osumi ka një gjatësi prej 161 km dhe sipërfaqe pellgu 2150 km². Ai buron nga lartësia e malit të Rungajës dhe pasi kalon në një terren të thyer malor, hyn në gropën e Kolonjes ku fuqizon prurjen e tij me perrenj të shumta që rrjedhin nga mali i Gramozit. Në afërsi të Kozarës bashkohet me Devollin.

Pas Çorovodës, deri në Berat lugina përshkon formacionin flishor të zonës Jonike. Shtrati i tij përbehet nga aluvione të kuaternarit që vendosen mbi bazamentin flishor, të cilat pas grykës së Gorices formojnë një shtrat fushor deri në Kozarë ku bashkohet me Devollin.

1.10.2 Ndertimi gjeologjik i objektit

Depozitimet e kuaternarit të tipit të aluvioneve

Depozitimet e kuaternarit janë objekt i studimit të drejtpërdrejtë. Këto përfaqësohen nga depozitimet aluviale që ndertojnë shtratin aktual të lumit si dhe pjesën kryesore të taracave lumore.

Përqendrimi i tyre është pasqyruar në planimetri, pasi i është bërë një rilevim i saktë i zonës së kërkuar. Janë kryesisht rere, zhavorre e popla. Në meandrimet e lumit dhe në tarracat duken edhe rera e suargjila me trashësi të vogël.

Nga vërtetimet sipërfaqësore duket qartë se në të dy krahet e shtratit të lumit në zonën para fshatit Lllapan ndodhen depozitimet sedimentare kompakte të serise ranoro-argjilor të

Oligocenit (Pg13) me perhapje me te madhe e me évidente ne shpatin verior, e pjeserisht ate jugor.

Depozitimet karbonatike Cr₂

Keto depozitime perfaqesohen nga depozitimet e kretes se siperme te pandara. Konkretisht ato perfaqesohen nga gelqerore turbidike me rudiste dhe gastropode masive shtrese trashe ne pjesen e poshtme dhe shtrese trashe mesem ne pjesen e siperme. Permbajtja faunistike tregon per depozitime ne kushtet e nje deti te qete pra jane depozitime neritike.

PERBERJA MINERALE

Shtrati i lumit eshte i pasur me depozitime aluviale te konsiderueshme, kryesisht te llojeve shkembore ranore karbonate dhe magmatike e me pak mergelore te tipit zhavore, popla, zhure e rera. Trashesia e depozitimeve aluviale arrin ne deri 2-4 m dhe ne pjeset e meandrave deri ne 5m.

Ne aspektin mineralogjik Aluvionet kane kete perberje si magmatike ,efuzive ultrabazike ,formacione sendimentare karbonatike – shistore .

Nga studimet gjeologjike dhe laboratorike te kryera, mesatarja e permbajtjes se fraksioneve sipas dimensioneve ne perqindje si me poshte:

Ranor deri ne	22%
Karbonate deri ne	45%
Silicore zaje deri ne	28%
Magmatike deri ne	3%
Te tjere	2%

Ranoret jane te çimentuar me parmbajtje silicore pasi ne keto formacione lumi pershkron nje gjatesi te madhe dhe ne keto rrethana edhe prezenca e tyre ne keto raporte justifikohet.

Karbonatet perfaqesohen nga gelqerore te kretes se siperme Cr₂ te dolomitizuara pasi keto vijne si rezultat i kalimit te lumenjve ushqyes ne keto formacione.

Magmatiket perfaqesohen nga gabro e dunita shume te forta te cilat gjenden ne madhesi te ndryshme e te rrumbullakosura

Per arsye teknologjike perberja granulometrike e nenprodukteve te prodhuara nga kjo lende e pare duhet te plotesoje, sipas perdorimit, normat e meposhteme

Zhavoret lejohet te permbajne kokrriza me madhesi 5-10 cm

Rerat per llaçe duhet te jene brenda kufjve 0.15-1.2 mm

Permbajtja e kokrrizave pluhurore dhe argjilave, me madhesi nen 0.15 mm/mm, nuk duhet te kaloje masen mbi 10 % te peshes se reres per betonet, 15 % per llaçet e suvatimeve.

Permasat maksimale te kokrizave te reres qe perdoret ne llaçet per murature e suvatime te mos e tejkalojne:

- 5 mm per mure me gure .
- 1.25 mm per shtresen e dyte te suvase dhe dores perfundimtare

1.10.4. KUSHTET TEKNIKO – MINERARE TE VENDBURIMIT

Bazuar ne pershkrimin gjeologjik te vendburimit dhe ne ate hidrogjeologjik mund te themi se Aluvionet jane te shkrufta, me linja tektonike te rralla bejne ate qe kushtet e shfrytezimit te zones te jene te mira dhe per hire te lartesisë, klimes dhe kushteve hidrogjeologjike te favorshme te punohet ne vendburimin gjate gjithë vitit. Njekohesisht kushtet e mira te infrastruktures ne afersi te vendburimit krijojne lehtësi ne shfrytezim e transport.

1.10.7. KAPACITETI PRODHUES I ZONES, LLOGARITJA E REZERVAVE TE SHFRYTEZUESHME, JETEGJATESIA E KARRIERES SI DHE REGJIMI I PUNES.

Per llogaritjen e rezervave te inerteve ne zone (per te kater meandrat) jane trasuar dhe jane ndertuar profile dhe konkretisht :

- Per meandren Nr.1 (Zona 1 Sip. 0.28km²) profili gjatesor I-I dhe profilet terthore I-I, II-II, III-III, IV-IV (shih grafiket perkates). Per kete meander bazuar ne profilet topografike (nisur nga qellimi per mos formimin e gropave apo prishjen e pjerresise se lumit) germimi do te luhetet nga 0.4 deri ne 1.1ml (eshte zgjedhur nje trashesi e tille e inerteve qe do te shfrytezohen me qellim qe te mos behen demtime te shumta te shtratit te lumit dhe per ti dhene mundesi rigjenerimi sa me te shpejte te amjentit nepermjet prurjeve periodike vjetore te inerteve nga lumi).

- Per meandren Nr.2 (Zona 2 Sip. 0.17km²) profili gjatesor I-I & profilet terthore II-II, (shih grafiket perkates). Per kete meander bazuar ne profilet topografike (nisur nga qellimi per mos formimin e gropave apo prishjen e pjerresise se lumit) germimi do te luhetet nga 0.4 deri ne 1.1ml (eshte zgjedhur nje trashesi e tille e inerteve qe do te shfrytezohen me qellim qe te mos behen demtime te shumta te shtratit te lumit dhe per ti dhene mundesi rigjenerimi sa me te shpejte te amjentit nepermjet prurjeve periodike vjetore te inerteve nga lumi).

- Per meandren Nr.3 (Zona 3 Sip. 0.31km²) profili gjatesor I-I & profilet III-III, (shih grafiket perkates). Per kete meander bazuar ne profilet topografike (nisur nga qellimi per mos formimin e gropave apo prishjen e pjerresise se lumit) germimi do te luhetet nga 0.4 deri ne 1.1ml (eshte zgjedhur nje trashesi e tille e inerteve qe do te shfrytezohen me qellim qe te mos behen demtime te shumta te shtratit te lumit dhe per ti dhene mundesi rigjenerimi sa me te shpejte te amjentit nepermjet prurjeve periodike vjetore te inerteve nga lumi).

Ne objektin e kerkuar per shfrytezim rezultojne 134 019 m³ rezerva te llogaritura. Ndersa rezerva te shfrytezueshme rezultojne 127 318 m³

Per efekt te jetgjatesise se objektit jane marre ne konsiderate sasia prej 134 019 m³ rezerva te shfrytezushme.

1.10.8. REGJIMI I PUNES

Puna ne prodhim do te realizohet me nje nderrese me orar te zgjarur 10 ore deri ne 12 ore. Regjimi i punes do te jete ditor, deri 8 ore ne dite, javor 5 dite ne jave ose 20 dite ne muaj. Gjithsej gjate vitit parashihet te punohet 6 muaj ose 120 dite, te cilat me makinerite qe disponon shoqeria jane te mjaftueshme per perballimin e prodhimit ne rritje.

Ne rast nevoje punohet edhe me orar te zgjatur por planifikimi i shfrytezimit do te behet me nje nderrese. Punonjesit qe do te jene te angazhuar ne shfrytezimin e objektit do te jene edhe pjeserisht ne impiantin e shoqerise per prodhimin e granualteve dhe inerteve te ndertimit

5.5 Organizimi

Kariera do te jete nenadministrimin e shoqerise SALILLARI shpk ku do te kete nje administrator, drejtues teknik dhe do te kete si, manovrator si dhe roje.

Ne kariere do te punohet vetem turnin e pare dhe puna do te jete teresisht e mekanizuar.

Masat për rregullimin e infrastrukturës

Në zonën e shfrytëzimit dhe afër saj nuk ka asnjë objekt industrial, social kulturor apo shtëpi banimi. Të tre krahët e kodrës janë plotësisht të mbrojtura, sepse terreni ngrihet gradualisht me një lartësi nga +35 m deri në kuotën +105 m dhe kjo pjesë ndërtohet nga alternime shkëmbinjsh gëlqeror, të cilat ndërtojnë edhe bazamentin e karrierës për shfrytëzim. Marrja e gurit gëlqeror në formë shtrese ka mundësi që në përfundim të shfrytëzimit të krijohet mundësia e sistemimit dhe mbjelljes së drurëve dhe shkurreve karakteristike të bimësisë së zonës.

Hapja e kanaleve për drenazhim midis kollonës mbrojtëse dhe zonës së shfrytëzimit

Midis kollonës së shfrytëzimit dhe kollonës mbrojtëse të karrierës për shfrytëzim do të hapen kanale me përmasa 60 x 50 cm dhe me pjerrësi 5 % nga të dy krahët e karrierës. Me anën e këtyre kanaleve do të sigurohet kullimi i ujërave të reshjeve atmosferike, të cilat do të drenohen direkt për në përroin që kalon pranë. Me këto masa do të evitohen fenomenet e erozionit në zonën e sigurisë dhe në të gjithë karrierën.

Punimet plotësuese për mbylljen e karrierës

Krahas punimeve për shfrytëzimin e karrierës, do të kryhen dhe punime që shërbejnë për mbylljen e saj, duke realizuar synimin përfundimtar, që është rehabilitimi ambiental i zonës së shfrytëzuar. Në këtë fazë parashikohet të bëhen:

- Hapja e rrugëve lidhëse të shesheve të depozitimit të mbetjeve dhe dherave në zona që nuk do të shfrytëzohen
- Sistemimi i skarpateve për një rikthim të peisazhit në një gjendje të përafërt me atë të parashfrytëzimit
- Mbjellja e fidanëve në zonën e kollonës mbrojtëse dhe në zonën që do të shfrytëzohet

- Sistemimi dhe punime sigurimi për depozitimin e mbetjeve
- Shmangia e gropave apo thellimeve në zonën e shfrytëzuar dhe brigjeve
- Risjellja e shpateve dhe brigjeve në të njëjtat kushte si para shfrytëzimit
- Parashikimi dhe realizimi i masave të ndryshme restauruese për një regjim normal të rrjedhjes

5. Informacion mbi përzgjedhjen e vendndodhjes së projektit

Theksojmë se jemi në një zonë plotësisht të destinuar për aktivitete të prodhimit të materialeve inerte, dhe nuk ka asnjë banesë pranë këtij objekti. Po ashtu sipërfaqet e lira rrethuese të objektit do të mbillen me pemë dekorative, në bazë të planit të rehabilitimit të lumit.

Në mënyrë të përmbledhur, aspektet positive të përzgjedhjes së vendndodhjes ku do të zhvillohet ky aktivitet paraqiten si më poshtë:

- ❖ Nga vlerësimi i zonës rezulton se në këtë zonë nuk ka
 - Pasuri natyrore tokë bujqësore, pyje, kullota;
 - Vepra të infrastrukturës si rrugë automobilistike;
 - Linja tensioni të lartë;
 - Vendbanime apo objekte social-kulturore;
 - Vepra arti apo vepra të tjera të mbrojtura me ligj;
 - Monumente të karakterit historic, të trashëgimisë kulturore, gjeomonumnte të arkeologjisë apo të tjera që mund të dëmtohen nga zhvillimi i aktivitetit;
- ❖ Vendi i karrierës ndodhet larg nga zonat e banuara, në një distancë rreth 1 km nga zona më e afërt;
- ❖ Lumi siguron volum të madh dhe cilësi të inerteve;
- ❖ Ka infrastrukture pothuaj të gatshme;
- ❖ Mbetjet teknologjike të dala nga shfrytëzimi i karrierës do të përdoren për qëllime rehabilitimi, ose qëllime të vet subjektit;
- ❖ Toka është e lirë nga sipërfaqja bujqësore apo pyjore;
- ❖ Kryerja e aktivitetit në përgjithësi nuk krijon ndotje të ujit, ajrit dhe tokës.

Dalja e Aluvioneve direkt në sipërfaqe dhe është shumë e favorshme për fillimin e shfrytëzimit, pa shpenzime të mëdha për shoqërimin për prodhimin e ranorit konglomeratik.

Për zgjedhjen e sistemit të shfrytëzimit që do të përdoret për shfrytëzimin e objektit kemi pasur parasysh këto faktore:

Menyra e transportit të sterilit

Menyra e kryerjes së punimeve të zbulimit

Tipet e mjeteve dhe mekanizmave që parashikohen për ngarkim dhe transport

Shoqëria parashikon që ngarkimi i sterilit dhe i ranorit të bëhet me eskavator me sistem të ecjeve me zinxhira dhe kapacitet kocke 1.5m³.

Bazuar per sa me siper mund te perdoren keto sisteme shfrytezimi:

- Sistemi i shfrytezimit i thjeshte pa transport
- Sistemi i shfrytezimit me transport ne perdorimin e automjeteve per transport.

Ne kete kariere do te perdoren te dy sistemet e shfrytezimit. Ne anen veriore te objektitit ku ndalesa eshte pothuajse e paperfillshme do te perdoret sistemi i shfrytezimit pa transport mbasi sasia shume e vogel e sterilit do te perzihet me gurin dhe do te shitet si çakull per shtrim rruge.

Ne anen Veri Perendimore ku mbulesa do te jete me e madhe do te perdoret sistemi i shfrytezimit me transport. Sterili qe do te dale gjate zbulimit do te ngarkohet me automjete dhe do te depozitohet ne vende te veçanta ne horizontet e meposhteme te karrieres.

6. Identifikimi i ndikimeve

6.1. Ndryshimet ne popullsi

Aktiviteti i firmes SALILLARI shpk ne shfrytezimin e inerteve lumore ne zonen e fshatit eshte shume i vogel ne krahasim me popullsi e rajoni.

Vete personeli i kufizuar qe do te punoje ne shfrytezimin e karrieres deshmon se nuk ka asnje ndikim ne popullsi.

Por duke e pare ne kontekstet e shfrytezimit teresor te karrieres mund te themi se shfrytezimi ne fjale do te kete ndikim pozitiv ne popullsi e zones, duke kontribuar drejtpersdrejti ne rritjen e mireqenies se tyre ne permisimin e infrastruktures se zones dhe punesimin e tyre.

6.2. Ndikimet e dukshme te projektit ne zonat rrethuese dhe pejsazhi

Gjate shfrytezimit te objektit parashikohet regjenerimi hap pas hapi i karrieres se ranorit konglomeratik dhe kryerja e punimeve suplementare te mbushjes dhe sistemimit. Ne vendet e caktuara ne projekt parashikohet depozitimi ranorit te paperdorshem dhe perpunimi i tij me token vegjetale per te mundesuar mbjelljen bimet e pemet dhe pemeve karakteristike per kete zone te gjelberuar dhe me shlodhese per syrin.

6.3. Nivelet dhe ndikimet e emetimeve te ardhura nga projekti i zhvillimit gjate fazes normale te operimit

Gjate fazes normale te operimit te projektit nuk do te kete emertime te gazrave, lengjeve, mbetjeve toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme, te cilat mund te

ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin perreth, duke perfshire te gjitha llojet e bimeve dhe gjallesave te ndryshme.

Gjate transportit te Aluvioneve do te punojne makinat e transportit, por qe nuk kane ndonje ndikim ne mjedis pasi qendrimi i tyre ne objekt nuk do te jete per nje kohe te gjate. Mjetet e transportit nuk do te krijojne ndonje problem ne trafikun e mjeteve pasi dhe numri i tyre do te jete i vogel.

6.4. NIVELET DHE NDIKIMET E ZHURMAVE NGA PROJEKTI ZHVILLUES

6.4.1 ZHURMAT

Zhurma ne kete objekt do te shkaktohen vetem nga kova e eskavatorit qe do te beje shfrytezimin e Aluvioneve te cilat do te jene shume te vogla sic thame me siper pasi zhurma e kesaj kove eshte mosperfillese fare.

Zhurmat e tjera do te jene nga mjetet e ngarkimit dhe atyre te transportit.

Niveli i zhurmave te ketyre makinerive, eshte i atij niveli qe nuk influencon fare si per te punesuarit dhe per banoret dhe gjallesat per rreth tij.

Fenomene te tilla si vibracion, ndricim, nxehtesia jane te paperfillshme ne zhvillim te ketij aktiviteti ne kete objekt. Duhet theksuar qe vibracioni ne kete aktivitet nuk eshte i pranishem.

Siç thame edhe me siper, zhurmat e vetme qe do te krijohen gjate procesit te punes ne objekt jane vetem ato te shkaktuara nga makinerite e shfrytezimit, te ngarkimit e te transportit te cilat ato jane te pa perfillshme.

Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate dites, meqenese ne objekt do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi

6.4.2 EMETIMET NE AJER

Emetimet ne ajer perfaqsohen nga gazrat qe dalin nga mjetet motorrike, si ato te shfrytezimit, te ngarkimit e te transportit te cilat jane shume te vogla, pothuajse te pa perfillshme.

Duke marre edhe parasysh qe qendrat e banuara nuk jane ne nje distance relativisht te larget nga zona e shfrytezimit keto emetime jane mosperfilllese.

Emetimet e tjera ne ajer perfaqsohen vetem nga gazrat e materialeve me djgje te brendeshme te makinave te ngarkimit dhe te mjeteve transportit qe do te perdoren per shfrytezim.

6.5. Ndikimet e projektit te zhvillimit ne rruget lokale dhe transportit

Sot per sot objekti eshte i lidhur me rrugen e makines. Ky segment rruge mirembahet dhe do te mirembahet ne te ardhmen nga subjekti dhe nga kjo rruge do te hapet nje rruge per te shkuar ne kuoten me te larte ne karriere.

Intensiteti i levizjes se makinave te transportit te subjektit ne kete segment nuk do ta rendoje trafikun aktual, kjo per faktin se ne kete segment rrugor parashikohet te levizin rreth 6 kamiona ne dite.

Mjetet e transportit qe jane te tonazhit te ulet (20 ton) do te sherbejne dhe si mjete levizese per banoret e zones.

Keto mjete do te jene te nje cilesie te larte dhe nuk do te perbejne asnje problem per komunitetin e kesaj zone perkundrazi do te jene nje ndihme per ta.

6.6. Ndikimet e projektit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike si dhe mbi vepra te tjera njerezore

Si rezultat i zbatimit te projektit ne kete zone nuk ka ndikim negativ mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike dhe mbi vepra te tjera njerezore, sepse ne kete zone dhe perreth saj nuk ka asnje objekt te nje rendesie te vecante te karaktereve te lartpermendura.

6.7. Humbja dhe demtimi i tipareve gjeologjike, paleontologjike.

Problemi i ambientit gjeologjik

Studimi gjeologjik i Aluvioneve per karrieren ne zonen ne fjale u krye me rilevim gjeologjik siperfaqesor duke studiuar cveshjet natyrore te objektit dhe karrieren qe do te shfrytezoje

shoqeri ate cilat ishin te mjaftueshme per hartimin e hartes gjeologjike 1:1000 te vendit ku do te hapet karriera.

Duke filluar nga lart poshte do kemi kete prerje: Aluvione depozitime te vjetra aluvjale, dhe me poshte kemi ranoreve. Pra ne kete zone nuk demtojme vlera gjeologjike.

6.8. Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitete duke perfshire ndikimet nderkombetare

Sikunder eshte trajtuar edhe me lart, nga zbatimi ne praktike i projektit te shfrytezimit te Aluvioneve ne siperfaqen e kerkuar, nuk ka dhe nuk jane parashikuar ndikime individuale apo te grumbulluara ne biodiversitet. Objekti eshte ne brendesi te territorit te vendit dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

6.9. Konsekuenca te tjera ekologjike

Ushtrimi i aktivitetit ne shfrytezimin e inerteve te ketij objekti nuk sjell pasoja te tjera ekologjike. Me hollesisht te dhenat konkrete per ndikimin e mundshem ne aspektin mjedisor jane dhene ne paragrafet e vecante, qe flasin per aspekte te vecanta te ndikimit mjedisor.

6.10. Ndikimet fizike te projektit ne ndryshimet e topografise lokale, erozionit te tokes etj.

Gjate dhe pas perfundimit te shfrytezimit, do te kete ndryshime te vogla ne topografine lokale.

Ne projekt eshte parashikuar nje radhe dhe drejtimi i tille i shfrytezimit, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojne erozionin e shpateve te karrieres.

6.11. Ndikimet e emetimeve kimike dhe depozitimeve ne toke dhe rrethinat

Aktiviteti parashikon vetem shfrytezimi te Aluvioneve dhe nuk leshon ne ambjent elemente kimike ose te tjera te demshem per mjedisin.

Materiali, qe do te depozitohet ne vendet e shfrytezimit, eshte i paster dhe me tregues fizike, petrografike, kimike. Aktualisht nuk ka asnje veprimtari industriale apo artizanale qe te jete shkak per grumbullime te demshme per mjedisin dhe jeten e njerezve.

7. Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmtim të mjedisit ndërkufitar. Projekti nuk ndikon në çëimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit as të shteteve fqinjë, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore ndërkufitare, nuk ndikohet cilësia e ajrit në kontekstin ndërkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendndodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kuirin dhe shtetet fqinjë.